

KËRKIME GJUHËSORE

Leonard DAUTI

RAPORTI MËNYRË-MODALITET NË GJUHËN SHQIPE

Abstrakt. Në lidhje me kategorinë e mënyrës në gjuhësinë shqiptare janë ravijëzuar dy qëndrime të ndryshme. "Gramatika e Gjuhës Shqipe" e vitit 2002, (Morfologjia, botim i Akademisë së shkencave), e karakterizon mënyrën si kategori gramatikore që lidhet me raportin e veprimit të shprehur prej foljes me realitetin e jashtëm, si dhe me shprehjen e modalitetit. Qëndrimi tjetër, i përfaqësuar së pari nga Fatmir Agalliu, i pasuar edhe prej gjuhëtarëve të tjerë, e trajton atë si shprehje të modalitetit. Sipas njërit qëndrim i njihen kategorisë së mënyrës dy përbërës të kuptimit gramatikor: tipari *realis/irealis* dhe *modaliteti*, ndërsa sipas qëndrimit tjetër vetëm një: *modaliteti*. Duke e parë modalitetin si objekt të studimeve të shumta në gjuhësinë bashkëkohëse, e gjykojmë me interes trajtimin e raportit mes tiparit *realis/irealis* dhe modalitetit edhe në gjuhën shqipe.

Lidhja mënyrë – modalitet. Mënyra dhe modaliteti lidhen me shprehjen gjuhësore të qëndrimit subjektiv të folësit ndaj kuptimit themelor të shprehur nga folja. Ky mendim përshkon përkufizimet e dhëna në gramatikat e gjuhës shqipe. Ajo çfarë nuk sqarohet prej tyre është se, ç'vend zë modaliteti në sistemin gramatikor të gjuhës shqipe, ku ndryshon nga mënyra dhe si duhet trajtuar ai në raport me kategoritë e tjera gramatikore karakteristike për sistemin foljor. Si një ndër temat e kërkimit intensiv shkencor, sidomos në periudhën pas viteve '80 të shekullit të kaluar, modaliteti është përcaktuar si shprehje gramatikore e qëndrimit subjektiv dhe opinionit të folësit (Lyons 1977:452; Bybee et al.1994: 176-181; Kosur 2009:1). Autorë të tjerë e trajtojnë atë si "kategori sintakso-morfologjike dhe kuptimore-pragmatike (komunikative)" (Lewandowski, 1994). Duke u përqendruar në studimin e plotë të sistemit modal të anglishtes, Frank Palmer e paraqet modalitetin si kategori gramatikore-semantike gjithëgjuhësore (Palmer 2001:1). Megjithëse në literaturën botërore mendimet dhe qëndrimet mbi modalitetin janë të ndryshme dhe kundërshtuese ndaj njëri-tjetrit, ato konvergojnë në dy pika: a) modaliteti nuk është pjesë përbërëse e veprimit, që përshkruhet në një fjali, por një mbishtesë që i ngjitet atij; b) përse i përket kuptimit, modaliteti klasifikohet në lloje të ndryshme dhe shprehet me anë të kategorive të ndryshme gramatikore (Droessiger, 2004:86).

Në mendimin gjuhësor "është pranuar gjerësisht se mënyra është shprehja morfologjike e modalitetit" (Agalliu, 1986:310). Mënyra konsiderohet si kategori gramatikore e rrafshit të formës kurse modaliteti kategori e rrafshit të përmbajtjes. Ashtu si koha edhe mënyra "është një koncept i rrafshit të shprehjes. Këshillohet që edhe në këtë aspekt, krahas koncepteve të rrafshit të shprehjes, të kemi koncepte të rrafshit të përmbajtjes, dhe kur i kemi, t'i përdorim si të tilla. Për konceptin e rrafshit të shprehjes mënyrë, si përgjegjës në rrafshin e përmbajtjes del koncepti modalitet" (Harweg, 1994:2). Ky raport i mënyrës me modalitetin dëshmohej edhe prej faktit se "numri pak a shumë i kufizuar i formave kohore të mënyrave të tjera, të cilat për nga modaliteti karakterizohen pozitivisht, është i

kushtëzuar nga lloji i kuptimeve modale që ato shprehin” (Heyse, 1856:429). K. W. Heyse e shihte mënyrën si shprehje të modalitetit përmes fleksionit të foljeve. Sipas konceptimeve të sipërpërmendura modaliteti lidhet me mënyrat e caktuara të shqipes (dëftore, lidhore, urdhërore, habitore, dëshirore), të cilat dallojnë me një paradigme të veçantë.

Shikimi i lidhjes mënyrë - modalitet si raport formë - përmbajtje nuk nënkupton ekzistencën e një raporti simetrik mes tyre. Me fjalë të tjera, nuk kemi po aq mënyra sa dhe kuptime modale. Duke qenë se kuptimet modale janë më të shumta në numër se sa mënyrat, morfologjikisht përdoret një mënyrë për të shprehur më shumë se një kuptim modal. Kështu lidhja shpreh modalitetin e mundshmërisë, të lejimit por edhe të domosdoshmërisë etj. Modaliteti paraqitet si një kategori tepër e gjerë. Mënyra është ndër mjetet kryesore për shprehjen e tij në gjuhën shqipe, por jo i vetmi. Në mbështetje të këtij mendimi vjen numri i madh i mënyrave të gjuhës shqipe, krahasuar me gjuhë të tjera europiane, si anglisht, gjermanisht, spanjisht, greqisht etj. Edhe në raport me italishten e frëngjishten shqipja paraqitet më e pasur në mënyra, po të kemi parasysh se numri i lartë i mënyrave në gramatikat e frëngjishtes dhe italishtes del falë trajtimit të formave të pashtjelluara si mënyra të mëvetësishme.

Kjo asimetri midis mënyrës, si formë shprehëse dhe modalitetit, si kuptim gramatikor, ka nxitur zhvillime të reja në hartimin e gramatikave të gjuhëve të ndryshme. Kështu mënyra nuk shikohet më si një kategori e mëvetësishme gramatikore e sistemit foljor, por një nënkategori e modalitetit, si në gramatikën e greqishtes së re, botim i vitit 1999 (Klairs/Babiniotis, 1999:84).

Palmer i njeh modalitetit dy nënkategori, **mënyrën** dhe **sistemin modal** (Palmer, 2003). Sipas natyrës së gjuhëve, analitike ose sintetike, është zhvilluar më tepër njëra ose tjetra nënkategori. Përgjithësisht në gjuhët analitike është mjaft i zhvilluar sistemi modal. Në gjuhët me eptim të zhvilluar, është mënyra mjet kryesor për shprehjen e modalitetit. Por këtu nuk ka kufij të prerë. Edhe gjermanishtja, megjithëse e ruan eptimin foljor, ka një sistemi modal mjaft të zhvilluar.

Modaliteti dhe realis/irealis. A është modaliteti kuptimi i vetëm gramatikor me të cilin lidhet ekzistenca dhe organizimi i mënyrave të gjuhës shqipe?

Në gramatikat e gjuhës shqipe dhe në gramatika apo artikuj studimorë të autorëve të veçantë kësaj pyetjeje i jepen përgjigje të ndryshme. Mënyra trajtohet si shprehëse e modalitetit dhe e raportit të veprimit të shprehur nga folja me realitetin e jashtëm në gramatikat e akademisë (FGII, 1976:233), dhe vetëm si shprehëse e modalitetit nga autorë të veçantë (Topalli 2010:172, Agalliu 1986:310). Duke e trajtuar mënyrën si shprehëse vetëm të modalitetit, e kemi të vështirë të japim një përgjigje bindëse për asimetrinë që ndeshet në format kohore dhe vetore të mënyrave të ndryshme të gjuhës shqipe. Përse dëftorja del me një numër më të madh kohësh e paradigme të plotë vetore krahasuar me lidhoren e urdhëroren? Përse habitorja, që ka një përdorim më të kufizuar krahasuar me lidhoren e dëshiroren, del më e pasur se to në format kohore?

RAPORTI MËNYRË-MODALITET NË GJUHËN SHQIPE

Fatmir Agalliu pranon dy nivele modaliteti që përcaktojnë kundërvënien e mënyrave në gjuhën shqipe: **modaliteti parësor** i vërtetësisë/pavërtetësisë, të cilin ai e lidh me raportin e veprimit me realitetin e jashtëm, dhe në bazë të të cilit kundërvihen lidhja me dëftoren, dhe **modaliteti dytësor**, të cilin ai e lidh me qëndrimin e folësit ndaj veprimit të shprehur prej foljes, që shërben për përligjen e mënyrave të tjera përtej lidhjes e dëftores (Agalliu, 1988:7-8). Termin ‘modalitet i vërtetësisë’ e përdor në kuptimin e shprehjes nga folja të veprimeve që janë faktike, d.m.th. që kanë ndodhur, ndodhin ose do të ndodhin realisht, ndërsa termin ‘modalitet i pavërtetësisë’ (irrealitetit) ai e përdor në kuptimin e shprehjes së veprimeve joreale, veprime që janë të ravijëzuara në mendjen e folësit dhe nuk pritët të kryhen në të vërtetë (Agalliu, 1988:7). Ky konceptim i modalitetit të vërtetësisë dhe pavërtetësisë, si raport i veprimit të shprehur nga folja me realitetin faktik apo atë mendor (jofaktik), i njeh kategorisë së mënyrës vetëm një kuptim gramatikor, atë të modalitetit, dhe e barazon modalitetin me konceptin realis/irealis. Në të mirë të idesë sonë për të mos barazuar tiparin realis/irealis me modalitetin e vërtetësisë/pavërtetësisë mund të sjellim këto argumenta:

- a. E kryera e thjeshtë (*aoristi*), që i referohet një veprim faktik, përdoret me kuptimin e të tashmes ose të ardhmes për të shprehur një shkallë të lartë sigurie për kryerjen e një veprimi ende jofaktik. Këtë e konstaton i pari K.Cipo (Cipo, 1949:114).
- b. Mungesa e modalitetit të lidhjes kur ajo përdoret në funksion të paskajores geqe të tipit *me punue*. Megjithëse ka edhe mendim të kundërt në bashkohemi me mendimin e Demirajt për modalitet zero të lidhjes në këtë pozicion,, duke qenë se ajo nuk mund të zëvendësohet prej ndonjë mjeti tjetër modal, gjë që është e natyrshme në rastet kur ajo shpreh modalitet.
- c. Shprehja prej lidhjes e modalitetit të vërtetësisë në ndërtime të tipit *shohim të ndërtohet, ndodh të dëgjojmë*. Në këto raste ajo mund të zëvendësohet prej dëftores.
- d. Shprehja e modalitetit të mundshmërisë prej dëftores. *Hekuri rrihet (duhet rrahur) sa është i nxehtë. Flihet (mund të flesh) mirë këtu*.
- e. Habitorja në asnjë rast nuk përdoret për të shprehur modalitet të vërtetësisë në gjuhën shqipe. Ajo përdoret prej folësit për ta paraqitur një **veprim real** si të papritur. Nuk mund të pranohet modaliteti i dyfishtë i habitores, ai i vërtetësisë dhe ai i habisë. E njëjta gjë (*modaliteti i dyfishtë*) vlen edhe për dëshiroren e urdhëroren në raport me lidhoren.

Rastet b, c, d, janë raste që dëshmojnë zhdukjen e kundërvënies modalitet i vërtetësisë / pavërtetësisë. Një formë e realit shpreh modalitet të pavërtetësisë dhe anasjelltas. Vërehet që tipari realis/irealis nuk përputhet me modalitetin e vërtetësisë / pavërtetësisë.

Është me vend të bëjmë një sqarim në lidhje me “modalitetin e vërtetësisë dhe pavërtetësisë” (Agalliu, 1988: 7-8). Në literaturën mbi modalitetin dallohet si një nënndarje më vete modaliteti epistemik (i njohjes), i cili i përgjigjet termit ‘modalitet i vërtetësisë dhe pavërtetësisë’ të përdorur në literaturën tonë. Ai

lidhet me njohjen e folësit dhe saktësisht me shkallën e sigurisë së tij për vërtetësinë e asaj që thotë (Klairs/Babiniotis, 1999:84). Sipas Palmerit me anë të modalitetit epistemik folësi shpreh gjykimin e tij mbi statusin e fjalisë (Palmer, 2001:8). Të njëjtin mendim e ndeshim edhe në gramatikat e gjuhëve të tjera përveç anglishtes. Modaliteti epistemik nuk na tregon faktikisht nëse ajo që thotë folësi është e vërtetë apo jo, por çfarë mendon folësi dhe sa i sigurt është ai për atë që thotë (Klairs/Babiniotis, 1999:85).

Pranimi i shprehjes së raportit të veprimit të shenjuar nga folja me realitetin e jashtëm si kuptim parësor i mënyrës, i jep përgjigje edhe pyetjes që parashtruar më lart, në lidhje me mospërputhjen midis mënyrave të ndryshme përsa i takon formave kohore. Dëftorja del më e pasur me forma kohore, konkretisht me formën e kohës së kryer të thjeshtë, jo sepse shpreh modalitetin e vërtetësisë, por sepse një veprim i realizuar, i kryer, i përfunduar, mund të jetë vetëm faktik, jo ireal, jo i mundshëm, jo i dëshirueshëm, dhe si i tillë shprehet me forma të realit.

Duke mëtuar se kemi arritur të saktësojmë dallimin dhe lidhjen midis modalitetit dhe mënyrës, mund të shpreheni për mënyrën si **kategori gramatikore morfologjike e dallueshme me paradigme të veçantë që shpreh:**

- **raportin e veprimit të emërtuar nga folja me realitetin e jashtëm, duke e paraqitur atë si raport real ose ireal, si dhe**

- **lloje të caktuara të modalitetit.**

Përkufizimi i formuluar në këtë mënyrë na jep mundësinë për të përshkruar më saktësisht organizimin e sistemit të mënyrave të gjuhës shqipe, si dhe të dallojmë qartësisht modalitetin, si kategori semantike-gramatikore, nga mënyra si kategori morfologjike e rrafshit të formës. Nga ana tjetër na lejon të trajtojmë modalitetin si modifikim subjektiv të kuptimit të predikatit, të cilin e kryen folësi/shkruesi sipas qëllimit të tij gjatë ligjërit, ose si kërkesë e diktuar nga faktorë objektivë.

Organizimi i mënyrave në gjuhën shqipe. Karakteristikë e shumicës së gjuhëve indoevropiane është krijimi i një sistemi binar të formave gramatikore të foljes në lidhje me shprehjen e realit dhe irealit. Kjo mënyrë organizimi përshkon si gjuhët me fleksion të zhvilluar ashtu dhe ato analitike. Në traditën e gjuhëve indoevropiane si mënyra foljore trajtohen tipat e dallueshëm mes tyre falë paradigmes zgjedhore. (Klairs/Babiniotis, 1999:91). Në bazë të këtij kriteri (paradigmatik) në gjuhën shqipe dalin me paradigme të veçantë dëftorja, lidhorja, urdhërorja, habitörja dhe dëshirorja. Mënyrat e foljes në gjuhën shqipe hyjnë në raporte të caktuara me njëra-tjetrën, raporte të cilat kushtëzohen nga dy tipare: a) **realis/irealis**, dhe b) **modaliteti**. Përsa i përket tiparit të parë sistemin foljor të gjuhës shqipe e karakterizojnë dy grupime kryesore, pasi të gjitha, ose pothuajse të gjitha, fjalitë janë reale ose ireale. Realiteti jashtëgjuhësor i konceptuar si real (veprime që ndodhin realisht në kohë të ndryshme) dhe ireal (veprime që nuk ndodhin realisht por që gjenden vetëm në mendjen e folësit) gjen pasqyrimin e tij edhe në realitetin gjuhësor, dhe konkretisht në **kundërvënien** që krijohet midis mënyrës dëftore dhe habitore nga njëra anë, si forma gjuhësore të shprehjes së

faktit, realit, (veprimi ndodh realisht) dhe asaj lidhore, urdhërore dhe dëshirore nga ana tjetër, si forma shprehëse të jofaktit, irealit, (veprimi ekziston si potencial në realitetin mendor të folësit). Kemi në këtë mënyrë dy grupime: **grupi i mënyrave të realit** (*dëftore, habitore*) dhe **grupin e mënyrave të irealit** (*lidhore, urdhërore, dëshirore*). Tipari real/ireal, si përbërës i qëndrueshëm i kuptimit gramatikor të foljes, nuk na ndihmon më tej për të justifikuar ekzistencën e formave të tjera paradigmatiche përtej atyre të mënyrës dëftore e lidhore. Përveç këtij organizimi të nivelit të parë (përdorim këtë term për arsye metodike) kemi edhe organizimin e nivelit të dytë, ku habitoria, dëshiroria dhe urdhërore nuk hyjnë në lidhje korrelative me njëra-tjetrën por me dëftoren (habitoria) dhe me lidhoren (dëshiroria, urdhërore). Këto lidhje kanë në bazë llojin e modalitetit. Ashtu si me kategorinë gramatikore të kohës, e cila është e organizuar në bazë të çifteve korrelative, edhe kategoria e mënyrës del si raport lidhjesh binare midis nënkategorive të saj. Dy mënyrat e realit si dhe tri mënyrat e rrafshit ireal dalin me paradigme të veçantë, duke iu kundërvënë qartazi njëra-tjetrës në llojet e modalitetit që ato shprehin.

“Është një praktikë e zakonshme në studimet tipologjike trajtimi i kategorive gramatikore si të përbëra prej bërthamës dhe periferisë”. (Palmer, 2005). Kundërvënia bazë edhe në sistemin foljor të shqipes është **dëftore - lidhore**: dëftoria si formë e realit, lidhoreja e irrealit. Kjo kundërvënie organizon **bërthamën e sistemit**. Lidhoreja, përfaqësuese e irrealit, me formë paradigmatiche më të plotë se urdhëroreja dhe dëshiroria, por edhe si mbartëse e modalitetit bazë krahasuar me to, pasi shpreh modalitetin e mundshmërisë dhe të domosdoshmërisë, dhe nga ana tjetër dëftoria, përfaqësuese e realit, me formën më të plotë paradigmatiche, e karakterizuar nga modaliteti i vërtetësisë. Ajo që organizon raportin e mënyrave periferike me bërthamën është kategoria e modalitetit. Kështu habitoria krijon çift binar me dëftoren, pasi ndryshojnë në llojin e modalitetit. Lidhoreja krijon lidhje treshe me dëshiroren dhe me urdhëroren sipas llojit të modalitetit. Këtë ndarje në dy grupime formalisht e mbështet edhe mënyra se si e formojnë mohoren mënyrat e ndryshme të shqipes. Format e realit në shqip, dëftoria dhe urdhëroreja, marrin pjesëzën **nuk**: *nuk punoj, nuk punuaka, nuk paska punuar, nuk do të punojë, nuk ka punuar* etj. ndërsa format e irrealit marrin pjesëzën **mos**: *të mos punoj, të mos kisha punuar, mos punofsha, mos paça punuar, mos puno, mos punoni* etj. Ky kriter formal ka vlerë praktike për dallimin dhe klasifikimin e formave të ndryshme foljore. Nga sa shqyrtuam më lart bërthama e sistemit të shqipes del e njëjtë me atë të gjuhëve të tjera evropiane. Vetëm periferia e këtij sistemi është më e pasur. Në anglisht, gjermanisht por edhe greqisht, pjesë e periferisë del vetëm urdhëroreja. Në shqip dalin urdhëroreja, habitoria e dëshiroria. Kjo dëshmon se në shqip mënyra është një mjet gramatikor i rëndësishëm për shprehjen e modalitetit, ndryshe nga gjuhët e tjera ku reduktimi i mënyrave të foljes i ka lënë vend krijimit të një sistemi të zhvilluar modal. Që kundërvënia themelore e sistemit të mënyrave në gjuhën shqipe është ajo e grupit të realit (dëftore dhe urdhërore) nga njëra anë dhe grupit të irealit (lidhore, dëshirore, urdhërore) nga ana tjetër, e dëshmon edhe fakti që dëftoria dhe

urdhërorja dalin me paradigmë më të plotë, ndërsa mënyrat e irealit dalin me paradigmë të reduktuar. Pra kundërvënja kuptimore (realis: irealis) gjen pasqyrim edhe në anën formale, në kundëvënien paradigmatiche.

BIBLIOGRAFI

- F. Agalliu, *Studime Filologjike* 2, 1968.
- F. Agalliu, *Çështje të morfologjisë së gjuhës shqipe*, Tiranë, 1988.
- K. Cipo, *Gramatika shqipe*, Tiranë 1949.
- Sh. Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe* (dispenca II), Tiranë 1961.
- Sh. Demiraj, *Rreth kategorive gramatikore të mënyrës dhe të kohës në gjuhën shqipe*, S.F. nr.3, 1977
- G. Droessiger, *Zum Begriff und zu den Arten der Modalität in der Linguistik*, Man and the Word (Žmogus ir žodis), issue: 03, vol.6 / 2004, s.86.
- DUDEN. *Die Grammatik*. Hrsg. von den Dudenredaktion. Band 4. Mannheim, Leipzig u.a.: Dudenverlag 7/2006.
- R. Facchinetti, M. Krug, & F. Palmer, (Eds.). *Modality in Contemporary English*. Berlin:Mouton de Gruyter, 2003.
- Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe II*, Tiranë 1976.
- S. Frashëri, *Shkronjëto e gjuhës shqip*, Bukuresht 1866.
- Gramatika e gjuhës shqipe. Vëllimi I Morfologjia*. Tiranë: Botimi i Akademisë së Shkencave 2002.
- Gramatika e gjuhës shqipe. Vëllimi II Sintaksa*. Tiranë: Akademia e Shkencave 1996.
- Roland Harweg, *Modus und Modalität*, në Jachnov, Mečkovskaja, Norman, Suprun, *Modalität und Modus*, 1994.
- F. Kiefer, *Modality*. In R. E. Asher (ed.), *The Encyclopedia of Language and Linguistics*, 2515-2520. Oxford: Pergamon Press, 1994.
- Kosur, Heather Marie, *A Linguistic Typology of Modality*, 2010.
- J. Lyons, *Semantics*. Cambridge: Cambridge University Press, 1977.
- F. R. Palmer, *Mood and modality* (Cambridge Textbooks in Linguistics). Cambridge: Cambridge University Press, 1986.
- K. Topalli, *Sistemi foljor i gjuhës shqipe*, Tiranë 2010.
- Χρήστος Κλαΐρης / Γεώργιος Μπαμπινιώτης, *Γραμματική της νέας ελληνικής*, II, Αθήνα 1999.